



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Kom.Dh.Shk.II.nr.990/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit KRM Eko Regjioni Sh.a., Njësia Operative Rahovec me NRB ..., kundër debitorit Qendra për Punë Sociale, me seli në Rahovec, për shkak të borxhit sipas dokumentit -Ekstraktit të Verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit dhe kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm KPPP.nr.513/22, të datës 26.05.2023, me datën 17.11.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit KRM Eko Regjioni Sh.a., Njësia Operative Rahovec me NRB ... , dhe debitorit Qendra për Punë Sociale, me seli në Rahovec, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm KPPP.nr.513/22 **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.513/22, të datës 26.05.2023, në piken I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit Qendra për Punë Sociale, me seli në Rahovec, ashtu që në piken II të dispozitivit e ka shfuqizuar pjesërisht urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.753/18 të datës 27.08.2018 për shumën prej 1,603.52€ për periudhën prej 01.03.2006 deri me 26.08.2015. Ndërsa në piken III të dispozitivit ka vendosur që të mbetet pjesërisht në fuqi urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.753/2018 i datës 27.08.2018, andaj për këto pjesë të urdhrin obligohet debitori Qendra për Punë Sociale, me seli në Rahovec, që kreditorit KRM Eko Regjioni Sh.a., Njësia Operative Rahovec t’ia paguaj borxhin për shërbimet publike-furnizim me ujë të pijshëm për periudhën kohore prej 28.02.2017 deri me 29.02.2020 në shumën totalë prej 737,52€, si dhe shpenzimet, deri në pagesën definitive.

Kundër aktvendimit në afatin ligjore, ankesë ka parashtruar kreditori për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit si e bazuar, aktvendimin KPPP.nr.513/22 të datës

26.05.2023 të anulohen dhe i njëjti të shpallet pa efekt juridik, ndërsa të mbetet në fuqi urdhëri përmbartimor P.nr.753/2018 i dt. 27.08.2018.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar edhe debitori për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e debitorit dhe të ndryshohet aktvendimi i atakuar, duke e aprovuar në tërësi prapësimin e Komunës së Rahovecit – Qendra për Punë Socialë, respektivisht të anuloje urdhrin përmbartimor P.nr.753/2018 të dt.27.08.2018 të Përmbartuesit Privat Gjakë Radi nga Gjakova.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

- Ankesat janë të pathemelta .

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 27.08.2018 ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit në bazë të dokumentit autentik –ekstraktit nga librat e kontabilitetit për shumën e detyrimit prej 2,341.04€.

Përmbartuesi privat Gjakë Radi me seli të zyrës në Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit -Ekstraktit të Verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit me Nr. G-012:2006-2018, i cili paraqet dokumente përmbartuese në bazë të nenit 21 , 22 dhe nenit 29 par.1.3 të LPP-së.

Kundër Urdhrit Përmbartimor në afatin e paraparë ligjor, prapësim ka ushtruar Debitori i Përmbartimit me të cilin ka theksuar se në tërësi e kundërshtojmë urdhrin përmbartimor, duke pretenduar se kreditori e kërkon realizimin e borxhit për periudhën 2006-2009, siç shihet nga renditja e faturave në dokumentin autentik të kreditorit, sepse nga viti 2010 asnjë fature nuk ka mbetur pa u paguar. Në muajt e fundit të pagesave sipas renditjes nga sistemi i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa të Komunës së Rahovecit, ku si provë bashkëngjit pagesat e muajve të fundit. Ka shtuar se dokumenti i besueshëm në të cilin është bazuar propozimi për përmbartim nuk është dokument i verifikuar dhe nuk paraqet bazë për nxjerrjen e urdhrit për caktimin e përmbartimit, për faktin se kreditori nuk është në gjendje të përcaktojë periudhën kohore, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit, të anulohet urdhëri i përmbartuesit privat, të bëjë përfundimin e përmbartimit në tërësi dhe të anuloje të gjitha veprimet e kryera.

Kreditori në afatin ligjore ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke e kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar, duke theksuar se bazuar në nenin 55 të LPP-së nuk ekziston asnjëra nga arsyet që debitori mund ti lejohet apo eventualisht ti aprovohet prapësimi, i ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar dhe i pa lejuar prapësimi i debitorit dhe të obligohet debitori që të kryej edhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Duke vepruar sipas prapësimit Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshme me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.513/22, të datës 26.05.2023, në pikën I. të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin i debitorit Qendra për Punë Sociale, me seli në Rahovec, ashtu që në pikën II të dispozitivit e ka shfuqizuar pjesërisht urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.753/18 të datës 27.08.2018 për shumën prej 1,603.52€ për periudhën prej 01.03.2006 deri me 26.08.2015. Ndërsa në pikën III të dispozitivit ka vendosur që të mbetet pjesërisht në fuqi urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.753/2018 i datës 27.08.2018, andaj për këto pjesë të urdhrit obligohet debitori Qendra për Punë Sociale, me seli në Rahovec, që kreditorit KRM Eko Regjioni Sh.a., Njësia Operative Rahovec t’ia paguaj borxhin për shërbimet publike-furnizim me ujë të pijshëm për periudhën kohore prej 28.02.2017 deri me 29.02.2020 në shumën totalë prej 737,52€.

Në arsyet e dhëna në aktvendimin e atakuar gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se sipas sugjerimeve dhe vërejtjeve të Gjykatës së Apelit sipas vendimit AC.nr.1902/19 të datës 22.01.2020 dhe pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas vlerësimit të provave që gjendjen në shkresat e lëndës, dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 69 dhe 71 të LPP-së ka gjetur se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se lidhur me pretendimet për parashkrimin e borxhit, duke u thirrur në e parashkrimit të paraparë me nenin 355 të LMD-së me numër NR. 04/L-077, gjykata e ka vlerësuar të bazuar për fakti se neni 355 par.1 konkretisht pika 2 neni thuhet citoj: *1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. 2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer*”. Ka vlerësuar se borxhi për periudhën nga data 01.03.2006 deri me datën 27.08.2015 me të cilin ngarkohet debitori është borxh i parashkruar. Po ashtu ka theksuar se sa i përket borxhit në shumën prej 737,52€ për periudhën kohore 28.08.2015 e deri me datën 27.08.2018 ka vlerësuar se është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim të borxhit të kreditorit në raport me debitorin për këtë periudhë kohore, meqenëse kreditori me datën 27.08.2018 ka ushtruar propozim për përmbarim, me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit konform nenit 369 të LMD-së. Prandaj, mbi këtë bazë dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 71 par.1.1 , 73 të LPP-së, nenit 12 par.2 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par.2 të Ligjit Nr.08/L-015.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbarimore. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se prapësimi për shumën prej 1,603.52€ për periudhën kohore 01.03.2006 deri me datën 27.08.2015 janë parashkruar sipas dispozitave të Nenit 355 të LMD-së të Ligjit (Nr.04/L-077). Kjo për faktin se edhe sipas vlerësimit të Dhomave të Shkallës së Dytë, për periudhën kohore 01.03.2006 deri me datën 27.08.2015 në bazë të dokumentit -Ekstraktit të Verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit me Nr. G-012:2006-2018,në bazë të së cilës është lejuar përmbarimi, kanë arritur afatin tre (3) vjeçar të parashkrimit dhe nuk mund të paraqesin dokument të besueshme dhe si e tilla janë të pa përshtatshme për

përmbarrim. Edhe sa i përket vendosjes si në pikën II. të dispozitivit të aktvendimit të atakuar, kjo gjykatë vlerëson se Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale drejtë e kanë konstatuar gjendjen faktike kur e kanë lënë në fuqi urdhrin për përmbarrim sa i përket shumës prej 737,52 për faktin se për periudhën kohore nga data 28.08.2018 e deri me datën 27.08.2018 në bazë të të cilave rrjedh kjo shumë e borxhit është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim të borxhit të kreditorit, me arsyetimin se meqenëse kreditori me datën 27.08.2018 ka ushtruar propozim për përmbarrim, me këtë rast ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit.

Po ashtu, Gjykata Komerciale- Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit, me arsyetimin se pasi që kreditori ka kërkuar realizimin e shumës së faturuar për një periudhë të caktuar kohë, vërtetohet se duhet të vlerësohet se faturimi dhe pagesat e bëra nga të cilat rezultojnë 737,52€ për periudhën kohore 31.08.2015 e deri me datën 27.08.2018 duke e llogaritur faturimit e bëra që përfshijnë 70 fatura apo shumën prej 737,52€ dhe pagesat e bëra për të njëjtën periudhë e që përfshijnë pagesat apo në shumën prej 627,44€, të gjitha këto të evidentuara në ekstraktin Kartela e Konsumatorit prej 01.03.2006-30.06.2018 me (Nr.G012) të lëshuar në emër të debitorit.

Andaj propozimi për përmbarrim ishte ushtruar në afatin e paraparë ligjor, po ashtu debitori nuk kishte ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të veta, siç është paraparë me nenin 69 par 4 të LPP-së se, andaj nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e tërësishëm të Urdhrit të Përmbarruesit Privat të përcaktuara me dispozitat e nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (Ligji nr. 04/L-139) të Republikës së Kosovës.

Kjo gjykatë i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore të kreditorit dhe debitorit, mirëpo të njëjta i vlerësoi si të pabazuar dhe të pambështetura në shkresat e lëndës.

Sa i përket pretendimeve ankimore se dokumentet e besueshme janë në kundërshtim me nenin 29 të LPP-së pasi që të njëjtat nuk janë dorëzuar konform këtyre dispozitave ligjore, kjo gjykatë vlerëson se dokumentet Ekstraktit të Verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit janë pranuar me rregull nga debitori dhe i plotësojnë kushtet për të qenë të përshtatshme për përmbarrim.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.990/23, me datë 17.11.2023

Gjyqtari
Dren Rogova